



Trepça Shoqëri Aksionare  
Trepça Joint Stock Companies  
Trepça Deoničarsko Društvo

Nr. 7331 Data 27. 11. 2024

Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare  
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Në bazë të nenit 21 paragrafi 21.1, 21.3 dhe 21.4 të ligjit për Ndërmarrje Publike dhe nenit 19, paragrafit 2 nënparagrafit 2.11 të Statutit të Trepça Sh.A., Komisioni i Auditimit në takimin e mbajtur më 25.11.2024, ka vendosur të shpall:

## KONKURS

**Pozita:** Zyrtar për Auditim të Brendshëm "Trepça" Sh.A.

**Vendi i punës:** Mitrovicë-Parku Industrial

**I përgjigjet:** Komisionit të Auditimit

**Kohëzgjatja:** Tri (3) vite me mundësi vazhdimi

**Paga:** Në bazë të vendimit të Bordit Mbikëqyrës

**Orari i punës:** I plotë

### 1. Kushtet e përgjithshme

Kandidatët për këtë vend pune duhet të jenë persona me integritet, të cilët plotësojnë kushtet e kualifikimit, kriteret e pavarësisë, duhet të kenë përvojë të nevojshme profesionale, shkollimin e kërkuar dhe kushtet tjera të kërkuara me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjit Nr. 05/L-120 për Trepçën, Statutin e Trepça Sh.A.

### 2. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Harton politikën e Auditimit të Brendshëm, në përputhje me Misionin e Auditimit të Brendshëm dhe elementët e detyrueshëm të Kuadrit të Praktikave Profesionale

Ndërkombëtare (Parimet Themelore të Praktikës Profesionale të Auditimit të Brendshëm, Kodit të Etikës, Standardeve dhe Përkufizimit të Auditimit të Brendshëm);

- Planifikon, organizon dhe të mbikëqyrë punën e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, duke përfshirë planifikimin, hartimin dhe menaxhimin e programit të auditimit;
- Përgatit dhe ekzekuton programe auditimi për të kryer auditime sipas planit vjetor duke përcaktuar objektivat e auditimit, kriteret e auditimit dhe duke identifikuar rreziqet dhe kontrollet;
- Verifikon përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si dhe ofrimin këshilla për përmirësimin e tij;
- Planifikon planin e rekrutimit e punonjësve, planin e trajnimeve për edukimin e vazhdueshëm profesional të auditorëve;
- Ushtron funksionin në mënyrë objektive, profesionale dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike nr. 06/L-021 dhe metodologjisë së auditimit të brendshëm për sektorin publik, të miratuar nga Ministria e Financave;
- Vepron në përputhje me Standardet e Auditimit të Brendshëm, Statutin e Auditimit dhe Kodin e Etikës;
- Harton dhe dorëzon planin strategjik dhe planin vjetor për rishikim dhe miratim të Komisionit të Auditimit;
- Verifikon përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregullt të sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim të garantojnë zbatimin nga Trepça Sh.A. të të gjitha ligjeve të aplikueshme në Kosovë;
- Monitoron dhe kontrollon zbatimin e vendimeve të Aksionarit, Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit në përputhje me Planin e Biznesit të ndërmarrjes;
- Përgatit raporte të auditimit duke identifikuar përparësitë dhe dobësitë, përfshirë dhënien e rekomandimeve dhe konkluzioneve;
- Siguron kryerjen e auditimeve me kërkesë të veçantë (ad hoc) dhe detyra tjera sipas kërkesës së Komisionit të Auditimit;

- Prezanton Raportet e Auditimit te Komisioni i Auditimit për shqyrtim dhe aprovim;
- Siguron se në bazë të dëshmive të mjaftueshme bëhet monitorimi i zbatimit të rekomandimeve të Auditimit të Brendshëm dhe planeve të veprimit të ndërmarrjes;
- Të monitoroj zbatimin e përgjigjes së menaxhmentit si resurs dhe zbatimin e të gjitha rekomandimeve të Komisionit të Auditimit;
- Të koordinojë kornizat e auditimit me auditorë të jashtëm;
- Të veprojë në besim të mirë ekskluzivisht për përfitime kolektive dhe për përfitime objektive të aksionarëve gjithmonë në përputhje me ligjin dhe statutin;
- Të ketë konsideratë adekuate për çështjet që duhet vendosur nga ata dhe të sigurojnë të gjitha informatat e nevojshme për marrjen e vendimeve të tilla, duke pasur parasysh ndërlikueshmërinë e tyre;
- Të shmang dhe shpalos konfliktet aktuale dhe potenciale ne mes te interesave të tyre personale (direkte dhe indirekt) dhe të interesave të Shoqërisë;
- Të ushtrojë kujdes të arsyeshëm, zell dhe aftësi gjatë përmbushjes së funksioneve të tyre;
- Të trajtojë si konfidenciale të gjitha informatat e pranuar me arsye nga zyra e tyre ose gjatë zbatimit të detyrave të tyre;
- Përveç detyrave dhe përgjegjësiave të cekura, kryen edhe detyra të tjera të kërkuara nga Komisioni i Auditimit.

### **3. Kualifikimi dhe përshtatshmëria profesionale**

Një kandidat për t'u zgjedhur në pozitën e Zyrtarit për Auditim të Brendshëm të Trepça Sh.A., duhet t'i përmbush kriteret sipas Ligjit për Ndërmarrje Publike Nr. 03/1-087 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-111 dhe Ligjin 05/L-009, neni 21 Paragrafi 4 që i referohet dispozitave të mëposhtme:

- Të gjithë kandidatët potencial për këtë pozitë duhet të jenë persona me integritet të lartë të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1 (ii) i plotëson kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat (d), (f), (j), (k) dhe (l), nuk janë, ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës tridhjetë e gjashtë (36) muajsh para datës së aplikimit nuk kanë qenë

- Drejtorë të Bordit të kompanisë gjegjëse dhe (iv) kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë;
- Kandidati duhet të jetë diplomë universitare, Fakulteti Ekonomik, Juridik, Financa Publike, Kontabilitet apo fushat tjera të studimeve që përshtaten me veprimtarinë e ndërmarrjes;
  - Kandidati duhet të ketë certifikatë të Auditorit të Brendshëm në sektorin publik, e lëshuar nga Ministria e Financave ose certifikatë për Auditor të Brendshëm në sektorin publik/privat nga ndonjë institucion relevant ndërkombëtar apo vendor në pajtueshmëri me kriteret e nxjerra nga Ministri i Financave (dëshmi);
  - Kandidati duhet të jetë ekspert i certifikuar në kontabilitet (kontabilist i certifikuar)
  - Kandidati duhet të ketë së paku 5 vite përvojë pune në menaxhment të lartë në fushën e Auditimit, preferohen kandidatët me përvojë pune në ndërmarrjet/korporatat tjera të mëdha me dhe kompleksitet të lartë, duke përfshirë edhe kërkesat tjera që i parasheh neni 17 pika 3 e Ligjit 03/L-087, i ndryshuar dhe plotësuar më vonë;
  - Kandidati duhet të ketë integritet të lartë personal dhe profesional për ushtrimin e pozitës të Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm në NPQ “Trepça” Sh.A.
  - Kandidati duhet të jetë njohës i mirë i ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, me theks të veçantë Ligjin për NP dhe ligjet tjera që kanë të bëjnë me kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin e financave;
  - Kandidati duhet të ketë aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit dhe të bashkëpunimit me menaxhmentin dhe stafin e ndërmarrjes;
  - Kandidati duhet të ketë aftësi për vlerësim të rrezikut, analizim, definim të problemeve dhe dhënie të rekomandimeve;
  - Kandidati duhet të ketë aftësi të delegimit dhe monitorimit të autoritetit dhe përgjegjësisë tek bashkëpunëtorët për kryerjen e funksioneve të deleguara;
  - Kandidati duhet të ketë njohuri të mirë të gjuhës angleze, në të folur dhe në të shkruar;
  - Kandidati duhet të ketë njohuri të mira të kompjuterit dhe pakos Microsoft Office.

## **INFORMATË E PËRGJITHSHMË PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT**

**Kandidatët për pozitën e Zyrtarit Kryesor Financiar dhe të Thesarit të “Trepça” Sh.A., duhet të dorëzojnë këto dokumente:**

- Aplikacionin (i cili shkarkohet online)
- Letër motivuese
- CV (jo më shumë se tre faqe)
- Kopjen e ID/Pasaportës
- Dëshminë e përvojës menaxheriale nga punëdhënësi (dëshmi edhe nga trusti pensional)
- Certifikatën mbi dënimet penale që dëshmon se nuk është i dënuar me aktvendim të formës së prerë (jo më të vjetër se gjashtë muaj)
- Deklarata nën betim (shkarkohet online)

Çdo përgënjeshttrim material, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca, ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipërpërmendur, do të rezultojë në diskualifikimin e menjëhershëm.

I gjithë dokumentacioni duhet të dorëzohet me përmes postës elektronike: [hr@trepcasha.com](mailto:hr@trepcasha.com) duke cituar në “Subject” titullin e pozitës që aplikon.

Kandidatët me dokumentacion të mangët, të pa plotësuar dhe jo adekuat do të refuzohen. Po ashtu, dokumentet e dorëzuara pas fatit të paraparë për mbyllje të konkursit publik nuk do të pranohet.

Diplomat universitare të marra jashtë shtetit, duhet të dorëzohen me vendimin për nostrifikim nga MASHT.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur që i plotësojnë kushtet do të ftohen në intervistë.

Afati i konkursit është i hapur 15 ditë nga data e publikimit në ueb faqen e Trepça Sh.A., dhe në shtypin ditor.

***Afati i fundit për aplikim:*** 11.12.2024